



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punlyeno/Prodato Received/Delivery	07.03.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedrnica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMShCK	1198/2022		1/1



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

Nr. 05 /2022  
Datë: 04/03/2022

Në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, nenit 7 paragrafit 1 nën paragrafi 1.6, nenit 20 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 6 paragrafi 1, 2, 4 dhe 5, nenit 14 paragrafi 1 të Rregullore Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave të Legjislationit për Shërbimin Civil, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mbledhjen e trete (III) të mbajtur më datë 04.03.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti për Monitorim të Jashtëzakonshëm në Administratën Tatimore të Kosovës.
2. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e tij së bashku me rekomandimet e dhëna në raport.
3. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.



**Vendimi i dërgohet**

- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të Këshillit;



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorëzuar Prilimje/Prodato Received/Delivety	07. 03. 2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SMSHCK	1198/2022		116



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**RAPORTI I MONITORIMIT TË JASHTËZAKONSHME TË ZBATIMIT TË  
RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL  
NË  
ADMINISTRATËN TATIMORE TË KOSOVËS**

Prishtinë, Mars 2022

## TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje .....	3
Funksioni i Monitorimit.....	3

## FUSHA E MONITIRIMIT TË JASHTËZAKONSHËM

Këshilli, gjatë implementim të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, bënë monitorim të jashtëzakonshëm në rastet kur kërkohet nga nëpunësit civil. Në këtë rast dy nga të punësuarit në Administratën Tatimore të Kosovës z. Hamdi Hoxha dhe z. Bashkim Shala, kanë parashtruar kërkesë për monitorim të jashtëzakonshëm lidhur me mos zbatimin e Vendimit A.nr.474/2021 të datës 18.06.2021 dhe Vendimit A.nr.461/2021 të datës 23.06.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Administrata Tatimore e Kosovës pas pranimit të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.07.2021 ka njoftuar që ka bërë zbatimin e Vendimit A.nr.461/2021 për rastin e ankuesit Bashkim Shala, ndërsa më datë 12.07.2021 ka njoftuar se ka zbatuar Vendimin A.nr.484/2021 për rastin ankuesit Hamdi Hoxha.

Ankuesit kanë njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, se vendimet nuk janë zbatuar për faktin që nuk i ushtrojnë detyrat sipas përshkrimit të punës lidhur me pozitat e Zëvendës Drejtorëve në ATK

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka ndërmarr veprimet për faktin që më datë 30.06.2021 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka shkarkuar anëtarët e Këshillit, ndërsa ankuesi Hamdi Hoxha më datë 10.12.2021 ka parashtruar kërkesë për monitorim të jashtëzakonshëm në ATK lidhur me moszbatimin e plotë të Vendimit A.nr.484/2021, ndërsa Bashkim Shala më datë 20.12.2021 ka parashtruar kërkesë për monitorim të jashtëzakonshëm në ATK lidhur me moszbatimin e plotë të Vendimit A.nr.461/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mbledhjen e datës 23.12.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 11/2021 me të cilin ka bërë aprovimin e kërkesës së palëve duke e obliguar kolegjin që të bëjë monitorim të jashtëzakonshëm në Administratën Tatimore të Kosovës.

Kolegji i caktuar për monitorim të jashtëzakonshëm, z. Eshref Shabani dhe z. Avdyl Bekteshi, më datë 11.01.2022 kanë realizuar vizitën e monitorimit të jashtëzakonshëm në Administratën Tatimore të Kosovës duke u takuar me Drejtorin e Përgjithshëm të ATK-ë.

Gjatë vizitës z. Shabani e pyet Drejtorin e Përgjithshëm të ATK-së se:

A janë zbaruar vendimet për këto dy raste dhe si është realiteti?

A ka ndonjë person që merr pagë të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së?

A nënshkruan dikush dokumente të ATK-së në emër të Zëvendës Drejtorëve të Përgjithshëm?

Lidhur me pyetjet e z. Shabani, Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së, dha përgjigjet si në vijim:

Vendimet e Këshillit nuk më kanë pëlqyer sepse kemi bashkangjitur prova të mjaftueshme në përgjigjet në ankesë se pretendimet e tyre ankimore kanë qenë të pabazuara, por kam qenë i detyruar t'i zbatoj vendimet e Këshillit dhe të njëjtat i kam zbatuar edhe pse është dilemë a ka qenë ligjërish në rregull që unë të bëjë zbatimin e tyre pasi këto pozita janë pozita të nivelit të lartë drejtues.

E kemi pasur të paqartë si me i zbatuar për faktin që Ligji për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura ka përcaktuar që Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm janë nëpunës civil të nivelit të lartë drejtues më mandat dhe kjo ka qenë shumë e paqarta për mua pasi që ATK ka katër Zëvendës Drejtor të Përgjithshëm dhe i kemi edhe dy ankesa

në Këshilli nga dy të tjerë e që për çudi nuk janë vendosur, ndërsa ky ligj i parasheh vetëm nga dy pozita të Zëvendës Drejtorëve të Përgjithshëm.

Më tej Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së, theksoi se meqenëse Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, pozitat e Zëvendës Drejtorëve në Agjencitë Ekzekutive i ka kategorizuar si pozita të kategorisë së lartë drejtuese, më datë 16.07.2021 i jam drejtuar me email zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, si të veprohet me personat që i kam të sistemuar në pozitat e Zëvendës Drejtorëve të ATK-së që kanë akt emërimi ndërsa tashmë këto pozita janë me mandat dhe nuk kam marr asnjë përgjigje, ndërsa pas kërkesës së ripërsëritur të datës 04.08.2021, më datë 23.09.2021 Ministria e Punëve të Brendshme ka lëshuar një opinion duke njoftuar që pas analizimit të kësaj çështje kanë konstatuar se nga 2012 pozitat e Zëvendës Drejtorëve të ATK-së janë përfshirë si pozita të reja, ndërsa personat e emëruar janë bërë me akt emërimi të përhershme, rrjedhimisht asnjë dispozitë ligjore e nivelit të lartë drejtues nuk është respektuar për këto raste, sepse në atë kohë nuk ka pasur dispozita **shumë të qarta se në cilën kategori hyjnë zëvendësdrejtorët**, me qenë se tashmë është e qartë, atëherë ATK është e obliguar që të hartojnë Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës.

Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së, njoftoj që më datë 30.09.2012 i ka dërguar shkresë zyrtare Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me opinionin e pranuar nga MPB, duke kërkuar që meqë pozita e zëvendësdrejtorëve janë pozita të kategorisë së nivelit të lartë drejtues, atëherë Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së nuk ka më asnjë kompetencë të bëjë shkarkimin e tyre sepse kjo është kompetencë e Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar një zgjidhje për këtë situatë. Po ashtu është kërkuar nga ministri që të përdor autoritetin e tij për ndërmarrjen e veprimeve në të kundërtën kam thënë që jam i obliguar të bëjë zbatimin e vendimeve të Këshillit. Mirëpo nuk kam marr përgjigje asnjëherë nga Ministri i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Ndërsa prapë i kam shkruar ministrit më datë 03.11.2021, 9.11.2021, 26.11.2021 dhe nuk kam marr përgjigje, po ashtu i kam shkruar edhe Zyrës së Kryeministrit më datë 03.12.2021 dhe 16.12.2021 por nuk kam marr përgjigje, rrjedhimisht jam në një situatë të palakueshme për këto raste.

“Sa për njoftim unë vendimet e Këshillit i kam zbatuar këta dy persona marrin pagat e Zëvendës Drejtorëve por nuk i kryejnë detyrat pasi që nuk kam mund t’iu jap detyra disa personave që janë duke u hetuar nga organet e drejtësisë për keqpërdorime”, kështu ka deklaruar Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së.

Po ashtu Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së njoftoj që Plotësim/Ndryshimi i Ligjit për Administratën Tatimore të Kosovës është në Qeveri, po ashtu e kemi dërguar edhe draft Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ATK, duke e harmonizuar me Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, por ende deri tani nuk kemi informata se deri në cilën fazë janë.

## **RAPORT PËR MONITORIMIN E JASHTËZAKONSHËM NË ADMINISTRATËN TATIMORE TË KOSOVËS**

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit të jashtëzakonshëm në Administratën Tatimore të Kosovës për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Administrata Tatimore e Kosovës lidhur me zbatimin e vendimeve të lartcekura të Këshillit, ka marr këto prova:

- Kërkesën për opinion ligjor lidhur me skadimin e mandatit për pozitat e zëvendës drejtorëve të përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës e datës 15.07.2021 nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së për Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Emailin zyrtar të datës 16.07.2021, 02.08.2021 dhe 04.08.2021 nga Ilir Murtezaj për Fahrije Ternava dhe Tefik Mahmuti;
- Kërkesën e përsëritur për opinion ligjor nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-ë e datës 04.08.2021 për MPB;
- Shkresë për Këshillim nga MPB për Drejtorin e Përgjithshëm të ATK-së e datës 23.09.2021;
- Shkorsën për miratimin e titullit të punës Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së e datës 03.05.2013 e lëshuar nga Ministria e Administratës Publike;
- Kërkesën për propozimin e lejimit të kodit të ri të koeficienteve nga AKT e datës 23.04.2013 për Ministrinë e Administratës Publike;
- Njoftimin nga Ministria e Administratës Publike për ATK i datës 17.04.2013;
- Emailin zyrtar nga Ilir Murtezaj për Tea Blakaj e datës 03.12.2021 dhe 16.12.2021;
- Emailin zyrtar nga Ilir Murtezaj për Hekuran Murati i datës 26.11.2021, 19.11.2021, 03.11.2021;
- Njoftimin lidhur me përgjigjen e pranuar nga MPB për Ministrin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve i datës 30.09.2021;
- Listën e pagave e muajit dhjetor;

### ZBATIMI I VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit i caktuar për monitorim të jashtëzakonshëm në Administratën Tatimore të Kosovës, bazuar në të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur:

**E GJETUR:** Meqë kemi shqyrtuar të gjitha provat e lëndës dhe kemi marr parasysh edhe deklaratën e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, kemi konstatuar se Vendimi A.nr.484/021 i datës 18.06.2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për rastin e ankuesit Hamdi Hoxha, dhe Vendimi A.nr.461/2021 i datës 23.06.2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për rastin e ankuesit Bashkim Shala, nuk janë zbatuar në tersi nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës. Bazuar në deklaratimet e Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së, dhe duke u bazuar në listën e pagave për muajin dhjetor 2021 z.Hoxha dhe z. Shala marrin pagën e Zëvendës Drejtorëve të Përgjithshëm të ATK-së, mirëpo nuk kryejnë asnjë detyre të këtyre pozitave respektive. Kështu që si kolegji i monitorimit të jashtëzakonshëm, kemi konstatuar që vendimet e lartcekura të Këshillit për këto dy raste nuk janë zbatuar në tersi, me këtë Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, nuk ka respektuar nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”*, rrjedhimisht moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit, paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës, siç parashihet me paragrafin 3 të nenit të lartcekur. Meqenëse Ligji për Administratën Shtetërore ka hyrë në fuqi me datë 03.03.2019 i cili në nenin 22 paragrafi 4 përcakton se “Në rastet e agjencive të mëdha dhe me veprimtari komplekse, në ligjin e themelimit të agjencisë mund të përcaktohet që drejtori ekzekutiv të mbështetet nga jo më shumë se (2) dy zëvendës drejtorë. Zëvendës drejtori është nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese sipas ligjit për zyrtarët publikë gjithashtu edhe Ligji për Zyrtarët Publik nr.06/L-114 këtë pozitë e përcakton si pozitë të nivelit të lartë drejtues, Kolegji konstaton se deri në fillimin e zbatimit të këtyre dispozitave Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së është i obliguar të bëjë zbatimin e plotë të Vendimeve të lartpërmendura të KPMSHCK-së.

Kolegji konstaton se me njoftimet e datës 09.07.2021 dhe 12.07.2021 nga ana e ATK-së për zbatimin e Vendimeve A.nr.461/2021 dhe A.nr.484/2021 ka bërë zbatimin e këtyre vendime ka vë në lajthitje KPMSHCK, sepse nuk është bërë zbatim i tërësishëm i vendimeve, përkundër që ankuesve i janë lëshuar akt emërimet dhe marrin pagat e Zv.Drejtorëve të ATK-së por se nuk ushtrojnë punët sipas, akt emërimeve dhe përshkrimit të detyrave të punës për Zv.Drejtorët.

**Rekomandim:** Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, që të bëjë zbatimin e plotë të Vendimit A.nr.484/2021 të datës 18.06.2021 dhe Vendimin A.nr.461/2021 të datës 23.06.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës siç parashihet me nenin 21 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

**Eshref SHABANI**  
**Kryetar i Kolegjit**  
**Avdy BEKTESHI**



**Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional**

**I dërgohet:**

Anëtarëve të KPMSHCK-së  
Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;  
Menaxherit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës dhe  
Arkivit të KPMSHCK.